



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.973/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushe Kosove Besarta Pllana nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.973/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushe Kosove Besarta Pllana nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushe Kosove Besarta Pllana nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, në të cilën shpreh pakënaqësi për interpretimin e nenit 8 te ligjit 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës. Interpretimi ka te beje me ndarjen e vendeve te përgjithshme te Kuvendit Komunal e qe ne rastin e saj kuota gjinore është përmbushur nga 18 meshkuj dhe 8 femra te cilat janë zgjedhur si pjesë e asamblesë komunale. Konsideroj se ka mangësi ne përlllogaritjen e kuotës gjinore dhe kërkon te merret parasysh deklarata e saj dhe te interpretohet edhe një herë neni 8 i ligjit për 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale ne Republikën e Kosovës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushe Kosove Besarta Pllana nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet interpretimi i nenit 8 te Ligjit për Zgjedhjet Lokale ne republikën e Kosovës për shkak te mangësive ne përlllogaritjen e kuotës gjinore.

Nga pretendimet e saj pala ankuese nuk e ka bashkangjitur asnjë prove ne lidhje me supozimet e saj .

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Anr.973/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**

***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*

